



FONDI PËR SIGURIM  
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS  
SË MAQEDONISË

[www.fzo.org.mk](http://www.fzo.org.mk)

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup  
Tel: 02 3289 054  
Qendra: 02 3289 000  
Faks : 02 3289 048  
E-mail: [info@fzo.org.mk](mailto:info@fzo.org.mk)



## ***BULETINI DITOR I FSSHM-së***

### ***PËRMBLEDHJE INFORMACIONESH NGA LËMIA E SHËNDETËSISË TË MARRA NGA SHTYPI DITOR DHE MEDIUMET ELEKTRONIKE***

***08 - 09 Dhjetor 2015***



FONDI PËR SIGURIM  
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS  
SË MAQEDONISË

[www.fzo.org.mk](http://www.fzo.org.mk)

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup  
Tel: 02 3289 054  
Qendra: 02 3289 000  
Faks: 02 3289 048  
E-mail: [info@fzo.org.mk](mailto:info@fzo.org.mk)



**PORTALB**  
dritare realiteti

## Ndryshime ligjore për kthimin e infermiereve në Shëndetin Publik



Infermieret, teknologët dhe teknologët radiologjik, me shkollë të mesme profesionale dhe të lartë, nëse duan, do të mund të kthehen nga Shëndeti Privat, në atë Publik. Këtë e mundësojnë ndryshimet më të reja ligjore të ligjit për mbrojtjen shëndetësore të cilën e ka përgatitur Qeveria dhe tanimë është në procedurë parlamentare, njofton Portalb.

Ashtu siç ka deklaruar sot, ministri i Shëndetësisë, Nikolla Todorov, ndryshimet ligjore kanë ardhur, si rezultat, sipas tij, i projektit të suksesshëm i cili është realizuar me mjekët e specializuar, ndërkaq qëllimi është që të rritet kualiteti në shërbimet shëndetësore, për të cilët punohet për kuadër të trajnuar, përgatitur dhe me përvojë.

Për këtë mundësi, ka shtuar Todorov, tanimë janë paraqitur 30 kërkesa për infermiere.

“Kusht për kthimin e infermiereve dhe teknologëve është që të kenë më së paku, tre vjet përvojë punë në ndonjë prej institucioneve shtetërore të shëndetit publik, ose shtatë vite përvojë punë në një institucion privat të shëndetit publik, të cilat i kryejnë aktivitetet e spitalit”, theksoi ministri.

Pas miratimit të ndryshimeve ligjore, do të publikohen konkurs në të cilin do të thirren që të paraqiten të gjitha infermieret të cilët i plotësojnë kushtet dhe duan të kthehen nga Shëndeti Publik Privat. /Portalb

**ALSAT**

## ‘Logopedët shqiptarë’, Ipçe arsyetohet me mos aplikimin në konkurset e ministrisë



Sekretari shtetëror në Ministrinë e Shëndetësisë Nasuf Ipçe, ka ndryshuar qëndrimin sa i përket mungesës së logopedëve shqiptar në entin e rehabilitimit pranë qendrës klinike universitare, por edhe në institucionet tjera shëndetësore ku



FONDI PËR SIGURIM  
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS  
SË MAQEDONISË

[www.fzo.org.mk](http://www.fzo.org.mk)

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup  
Tel: 02 3289 054  
Qendra: 02 3289 000  
Faks : 02 3289 048  
E-mail: [info@fzo.org.mk](mailto:info@fzo.org.mk)



trajtohen fëmijët me pengesa në të folurit, dëgjimit dhe zërit. Ai fillimisht kishte deklaruar se kjo mund të jetë edhe rezultat i mungesës së kuadrit të diplomuar shqiptar që më pas të thotë se kuadër mund të ketë, por se i njëjti nuk është paraqitur në konkurset e shpallura.

“Nuk mund të them që nuk ka logopedë shqiptar por konkurset për mua janë masa për të bërë krahasimin e asaj se a ka apo nuk ka logopedë shqiptar, sepse në konkurset e hapura vite me radhë nuk është paraqitur asnjë kandidat shqiptar. Përderisa ata kandidatë nuk janë paraqitur në konkurs, mua më ngel të mendoj që nuk ka logoped shqiptar”, tha Nasuf Ipçe, Sekretari shtetëror në Ministrinë e Shëndetësisë.

Por të kundërtën theksojnë logopedët shqiptar. Ata thonë se konkurse mund të jenë hapur, por jo në institutin e rehabilitimit apo në institucione tjera të kësaj natyre. Një nga to, Ajshe Bekirovska thotë se që nga diplomimi i saj para katër viteve ka ndjekur të gjitha konkurset e shpallura, por për logopedë nuk është hapur asnjë. Ajo ka diplomuar në vitin 2012 në Fakultetin e Mjekësisë në Shkup, ndërsa tani është në studimet e magjistraturës në fushën e logopedisë në Turqi.

“Te të gjitha konkurset kam aplikuar, por nuk munda të gjej punë. Ndërsa sa i përket në simpo dhe në klinikë, nuk ka pasur asnjë farë konkursi ,edhe të kishte pasur konkurs do të kisha aplikuar sigurisht, meqë i ndjek konkurset”, tha Ajshe Bekirovska, Logopede e diplomuar.

Çështja e punësimit të logopedëve shqiptarë erdhi pas ankesave nga prindërit e fëmijëve me probleme në të folur, të cilët kishin gati një vit që po kërkonin një të tille shqiptarë për trajtim të fëmijëve të tyre. Në Entin për Rehabilitimin e dëgjimit, të folurit dhe zërit nuk ka asnjë të punësuar shqiptarë, edhe pse kurimi i fëmijëve me pengesa në të folurit duhet të bëhet nga një specialist që flet gjuhën e tij amtare. Statistika flasin se mbi 10 për qind e popullsisë vuan nga probleme në të folurit. Çrregullimet më të shpeshta janë mos shqiptimi i shkronjave, të folurit ndër hundë, belbëzimi, të folurit me ndërprerje dhe të folurit e shpejtuar.



## Ajri i ndotur, përqendrimet e PM10 më të ulëta mëngjesin e sotëm

Ajri në Shkup, Manastir, Tetovë dhe Kërçovë edhe këtë mëngjes është i ndotur, edhe pse përqendrimet e grimcave PM10...



FONDI PËR SIGURIM  
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS  
SË MAQEDONISË

[www.fzo.org.mk](http://www.fzo.org.mk)

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup  
Tel: 02 3289 054  
Qendra: 02 3289 000  
Faks: 02 3289 048  
E-mail: [info@fzo.org.mk](mailto:info@fzo.org.mk)



Ajri në Shkup, Manastir, Tetovë dhe Kërçovë edhe këtë mëngjes është i ndotur, edhe pse përqendrimet e grimcave PM10 janë më të ulëta se ato gjatë natës.

Stacionet e matjes këtë mëngjes i kanë matur përqendrimet e grimcave PM10 nga 190 mikrogramë në Tetovë, 106 në Manastir, 83 në Kërçovë, Qendër 75, Karposh 69, Gazi Babë 60 dhe Lisiçe 57 dhe tek Rektorati 46 mikrogramë.

Gjatë natës ajri më i ndotur ka qenë në Tetovë me 798 mikrogramë të matura, në Lisiçe 559, Qendër 384, Karposh 350, Manastir 304, Kërçovë 283, Gazi Babë 273 dhe tek Rektorati 202 mikrogramë për metër kub./mia



## RDM: Qeveria të shpallë gjendje të jashtëzakonshme për ndotjen



Partia RDM e Liljana Popovskës ka kërkuar nga qeveria që urgjentisht ta braktisë kampanjën parazgjedhore dhe të shikojë në instrumentet matëse të ndotjes së ajrit dhe të pyetet për të sëmurët nga sëmundjet respiratore dhe kardiovaskulare, transmeton TetovaSot.

Nga kjo parti kanë kërkuar që qeveria ta bëjë sa më shpejtë këtë, dhe jo përgjegjësinë ta hedh te qeverisja locale. “Qytetet në Maqedoni janë sulmuar nga smogi I zi”, thekson kjo parti. Kjo part kërkon që të shpallet gjendeje e

jashtëzakonshme dhe e njëjta të zgjasë deri në mbarim të dimrit.

Ky rregjim, sipas kësaj partie nënkupton të stopohen të gjitha aktivitetet ndërtimore në qytete, të ndryshohet regjimi i trafikut dhe masa tjera që do të mundësojnë zvogëlimin e ndotjes./TetovaSot/